



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 9 të Rregullores MF -Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, duke vendosur sipas kërkesës së Drejtoreshës së DKA-së të datës 04.09.2020, Kryetari i Komunës merr

**VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR CAKTIMIN E ÇMIMIT FILLESTAR PËR SHITJEN E
BAGËTIVE NË ANKAND PUBLIK**

**Neni 1
Përbërja e Komisionit**

Formohet, komisioni për përcaktimin e çmimit fillestar për shitjen e bagëtive në ankand publik të cilat gjenden në fermën e Ekonomisë Bujqësore "Adem Gllavica", në përbërje si vijon:

1. Ismet Rexhepi, Ekonomia bujqësore, Kryesues
2. Brahim Duriqi, Drejtorati për Arsim, anëtar
3. Afrim Sadiku, Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari, anëtar

**Neni 2
Detyrat e Komisionit**

Detyrë e Komisionit është që të përcaktojë çmimin fillestar për shitjen e bagëtive të cilat gjenden në fermën e Ekonomisë Bujqësore "Adem Gllavica" në Lipjan dhe ti rekomandojë Kryetarit të Komunës çmimin fillestar për shitje për llojet e bagëtive si vijon:

| Nr. | Përshkrimi | Numri i bagëtive | raca | Gjinia | Numri amzë |
|-----|------------|------------------|-----------|-------------|------------|
| 1. | gjedh | 1(copë) | simental | femrore | Pa numër |
| 2. | gjedh | 1 (copë) | kombinume | mashkullore | 9567 |
| 3. | gjedh | 1 (copë) | simental | mashkullore | Pa numër |
| 4. | Dele | 11 (cope) | | femrore | |

**Neni 3
Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi menjëherë ndërsa me kopjen e këtij Vendimi do të njoftohen, Drejtorati për Arsim, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit .

1Nr. 400-42351
Lipjan, më 08.09.2020

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

